



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 36 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi propozimet për shpallje monument dhe zona të mbrojtura në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

**I. Shpallje monument kulture dhe zonë të mbrojtur:**

1. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture dhe zonë e mbrojtur për “Rrënojat e Kishës së Shën Mëhillit”, Kostar, Mesopotam. Delvinë
2. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture, dhe zonë e mbrojtur për “Kisha e Shën Mërisë”, Pec, Mesopotam, Delvinë.
3. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture, dhe zonë e mbrojtur për “Kisha e Shën Thanasit” Muzinë, Sarandë.
4. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture dhe zonë e mbrojtur për “Piktogramet në strehën shkëmbore pranë Rubikut”, Mirditë.
5. Miratimin e propozimit për zonën e mbrojtur “Kisha e Shën Mërisë”, Kameno, Sarandë
6. Miratimin e propozimit për zonën e mbrojtur “Kisha e Shën Thanasit”, Pecë, Delvinë.
7. Miratimin e propozimit për zonën e mbrojtur “Kisha e Manastirit të Shën Triadhës”, Kardhikaq, Delvinë.
8. Miratimin e propozimit për zonën e mbrojtur dhe saktësim të emrit në “Kisha e Shën Mërisë dhe shpella me piktura” Kostar, Delvinë.
9. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI